



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSIE E MADHE  
KESHILLI

Nr. 1326/5 .prot

Koplik më: 29 /05/2020

**V E N D I M**

**Nr 35 Datë 27 / 05 / 2020**

**PËR**  
**Miratimin e Projektit “NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT BAJZË DHE FSHATRAVE**  
**PËRRETH”.**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 27.05.2020, mbështetur në aktin normativ nr 3 date 15.03.2020 neni 5. Ne mbështetje te ligjit 139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”, neni 34 pika3 , neni54 pika dh,k ,dhe ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, si dhe rregullorja e Keshillit Bashkiak Malesi e Madhe Nr.17 datë 30.04.2020 Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe  
Me 19 vota pro:

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e projektit “Ndërtimin e Ujësjellësit Bajzë dhe fshatrave përreth”.
2. Miratimin si Prioritet i Bashkisë Malësi e Madhe te projektit “Ndërtimi I Ujësjellësit Bajzë dhe Fshatrave Përreth ”.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015”Për Vetëqeverisjen Vendore”.
4. U miratua më datë 27.05.2020.
5. U shpall me datë 29.05.2020.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Emirjan HASMUJAJ**



**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ilir HALAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TE ASETVEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr./360/ Prot.

Koplik, më 26.05.2020

RELACION

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 « Per veteqeverisjen vendore », bashkia Malesi e Madhe duke vleresuar hap pas hapi nevojat e popullsisë, shikon te arsyeshme qe ne fushen sigurimit te sherbimeve jetesore ndaj banoreve te saj, nje investim i rëndesishem eshte ndertimi i ujesjellesve, duke u mundesuar banoreve te Bashkise Malesi e Madhe furnizim me uje te pijshem ne menyre cilesore dhe te rregullt.

Ne kete aspekt, duke vleresuar njesite administrative ne territorin e Bashkise Malesi e Madhe dhe nevojat qe kane keto, shikohet i arsyeshem ndertimi i nje ujesjellesi per qytetin e Bajzes dhe fshatrave perreth, ne Njesine Administrative Kastrat, duke e trajtuar njekohesisht si prioritet te Bashkise Malesi e Madhe.

Duke qene se ujesjellesit jane investime te kushtueshme dhe mundesite financiare te Bashkise jane te paketa ne kete aspekt, do te kerkohet financimi i ketij ujesjellesi nga Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizimeve dhe Menaxhimit te Mbetjeve.

Vlera e projektit llogaritet te jete 513 463 119.58 (peseqind e trenbedhjete million e katerqind e gjashtedhjete e tre mije e njeqind e nentembdhjete presje pesedhjete e tete) leke me TVSH.

